

**URDHËR**  
**Nr. 183/5, datë 14.6.2021**

**PËR NJË NDRYSHIM DHE DISA SHITESA NË URDHRIN NR. 633, DATË 17.11.2020,  
“PËR NDALIMIN E GRUMBULLIMEVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË  
HAPURA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri nr. 2435, datë 27.5.2021,

**URDHËROJ:**

Në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, të ndryshuar, bëhet një ndryshim dhe disa shtesa si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrin, hiqet togfjalëshi “apo të hapura, konferencat” .

2. Pas pikës 1, shtohen pika 1/1 dhe pika 1/2 me përmbajtje si vijon:

“1/1. Ndalohen grumbullimet me më shumë se 50 persona në vende të hapura, tubimet, mbledhjet partiake, ceremonitë e festave, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore nga data 15.6.2021 deri në datën 28.6.2021. Grumbullimet sipas kësaj pike të respektojnë masat e distancimit social dhe protokollin e miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik.

1/2. Lejohen konferencat me kapacitet të reduktuar deri në 30% të pjesëmarrësve dhe në zbatim të protokollit të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik nga datë 1.7.2021. ”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE  
MBROJTJES SOCIALE  
Ogerta Manastirliu**